

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR “DEUTSCHCOLOR” SH.P.K.

Ne Tirane, sot ne date 17 Janar 2012, ortaku i vetëm i shoqërisë,
Mia MUÇA, e bija e Albertit, e dtl. 06.07.1974, lindur ne Elbasan dhe banuese ne
Tirane, shtetase shqiptare, me zotesi te plote juridike e per te vepruar,
themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin “**DEUTSCHCOLOR**”
“**SHPK**”

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj,
me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, ligjit nr. 9901 datë
14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për
Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 1

Emërtimi

Emri i shoqërisë është “DEUTSCHCOLOR” ndjekur pandashmërisht nga prapashtesa
sh.p.k, e cila përfaqëson formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjesi te Kufizuar.
Shoqëria “DEUTSCHCOLOR ” sh.p.k. do të ketë logon dhe vulën e saj e cila aprovohet
nga mbledhja e asamblesë së përgjithshme të Shoqërisë.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë se shoqërisë do te jete:

1. Import, eksport, tregtim llaçrash, pergatitje tullash, pajisje hidrosanitare, inerte, etj;
2. Prodhime llaçrash te gatshme, te thate te parapergatitura per ndertim dhe rruge, ne
thase dhe rifuxho, me baze çimento, allçie, bitumi, koll, llaç, fino, bojak, stuko,
bojra sintetike e natyrale me baze pigmentesh hekuri dhe atyre organike, prodhime
me baze silicatesh dhe pergatitje tullash, inerte te granulomentrise;
3. Punime te ndryshme te te gjitha ketyre materialeve;
4. Import-eksport i te gjitha ketyre.

Përshkrimi i objektit te shoqërisë ka natyre indikuese dhe jo kufizuese. Për realizimin e
qëllimit te saj shoqëria mund te bashkëpunojë me çdo person fizik apo juridik ne çdo
mënyrë qe e gjykon te dobishme.

Shoqëria ne çdo kohe mund te ripërcaktojë objektin e saj, ta shtojë apo pakësojë atë, me
vendim te asamblesë se shoqërisë.

Neni 3

Selia

Selia e Shoqërisë do të jetë në Durrës, në adresën: Autostrada Tirane-Durrës, km. 30,
godina Delta. Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj në territorin e Republikës së
Shqipërisë dhe jashtë këtij territori, duke hapur zyra apo degë ose nëpërmjet veprimtarive
të kryera në përputhje me misionin dhe statutin e shoqërisë si dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Kohëzgjatja


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papërcaktuar.

Vendosja e mëpasshme e një kufizimi në kohe është kompetence e mbledhjes së
përgjithshme të asamblesë së shoqërisë.

Neni 5

Regjistrimi i Kapitalit dhe Ortaket

Kapitali Themeltar i Shoqërisë është 100,000 (njëqind mijë) leke dhe është i ndare ne
100 (njëqind) kuota me vlere nominale 1,000 (nje mije) leke secila. Kapitali i shoqërisë
zotërohet 100% nga ortaku i vetëm i shoqërisë, Zj, Mia MUÇA.



Neni 6
Organet Drejtuese

- Asambleja e Përgjithshme.
- Administratoret e Shoqërise

Administrator i shoqërisë do të jetë **Znj.Mia MUÇA**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7
Inventari, Pasqyrat dhe Viti Financiar

Viti financiar fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht, viti i parë financiar do të fillojë në datën kur shoqëria është regjistruar dhe mbaron më 31 Dhjetor të të njëjtit vit.

Në përfundim të çdo viti financiar, Administratorët përgatisin inventarët, pasqyrat financiare dhe raportin gjithëvjetor të administrimit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi mbi kontabilitetin.

Fitimi neto i realizuar që ka rezultuar pas zbritjes së shpenzimeve si dhe vlerës së fondit rezervë, do tu kalojë aksionarëve në përputhje me përqindjen e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërisë ose mund të kalojë për investime me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Mbledhje e Zakonshme).

Mbledhja e Zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme mund të krijojë edhe lloje të tjera fondesh, përveç fondeve të parashikuara në nenin e mësipërm.

Neni 8
Prishja e Shoqërisë

Shoqëria priset:

- a) Me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- b) Me hapjen e një procedure falimentimi;
- c) Nëse nuk ka kryer aktivitet tregtare për periudhën e përcaktuar në ligj;
- d) Me vendim të Gjykatës.

Neni 9
Likuidimi i Shoqërisë

Përveç rasteve të parashikuara nga ligji, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme, mund të vendosë shkrirjen e parakohshme të shoqërisë dhe vënien e saj nën likuidim, kur miraton një vendim me këtë objekt të propozuar nga administratorët.

Për këtë qëllim, Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme do të përcaktojë procedurat dhe mënyrat e likuidimit, duke zbatuar dhe respektuar ato ç'ka janë parashikimet e ligjit.

Mbledhja e Jashtëzakonshme e Asamblesë së Përgjithshme, emëron një a më tepër likuidues, duke përcaktuar për secilin kompetencat dhe funksionet në kryerjen e procedurave të likuidimit.

Neni 10
Dispozita të Fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë akt, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
MIA MUÇA

